

LIGJI
Nr. 32/2016

**PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE INSTALIMEVE NËN
PRESION**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve e instalimeve nën presion, nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor, i cili përcakton kushtet dhe kërkesat thelbësore që duhet të respektohen nga operatorët ekonomikë që administrojnë apo shfrytëzojnë këto pajisje e instalime.

Neni 2

Objekti

Ky ligj përcakton:

1. Kushtet dhe kërkesat kryesore të sigurisë, që duhet të zbatohen në prodhimin, montimin dhe përdorimin e pajisjeve dhe instalimeve nën presion, me qëllim garantimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve shtëpiake, mjedisit dhe vlerave materiale, nga rreziqet e shkaktuara nga këto pajisje dhe instalime.
2. Të drejtat e kompetencat e inspektoratit shtetëror, përgjegjës për fushën e veprimtarisë së pajisjeve dhe instalimeve nën presion, si dhe të organeve kombëtare, të miratuara, e atyre europiane, të notifikuara, të vlerësimit të konformitetit, për pajisjet dhe instalimet nën presion.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Pajisje nën presion" janë pajisjet nën presion stacionar, enët e thjeshta nën presion dhe pajisjet transportuese nën presion, me presion të lejuar mbi 0,5 bar.
2. "Pajisje nën presion stacionare" janë enët, enët e thjeshta, tubacionet, aksesorët e sigurisë dhe aksesorët nën presion, të cilët përfshijnë edhe elementet bashkuese me pjesët e tjera të instalimit, ku bëjnë pjesë edhe flanxha, rakorde, manikota, mbështetëse, krahë të lëvizshëm etj.

3. "Enë nën presion" është një vëllim i mbyllur, i projektuar dhe i prodhuar për të mbajtur fluide që krijojnë presion mbi 0,5 bar, e cila, rast pas rasti, përfshin edhe elementet bashkuese për lidhjen me pajisjet e tjera.
4. "Enë e thjeshtë nën presion" është çdo enë e salduar, që i nënshtrohet një presioni të brendshëm manometrik mbi 0,5 bar, e cila është e përcaktuar të mbajë ajër ose azot dhe që nuk i ekspozohet flakës.
5. "Tubacione nën presion" janë tuba apo linja tubash, të destinuar për transportin e fluideve nën presion, përfshirë aksesorët e lidhjes së tyre dhe shkëmbyesit e nxehtësisë.
6. "Aksesorë sigurie" janë dispozitivët e projektuar për mbrojtjen e pajisjeve dhe instalimeve nën presion nga tejkalimi i kufijve të lejuar. Këta dispozitivë përfshijnë dispozitivë për kufizimin e drejtpërdrejtë të presionit, si valvola të sigurisë, dispozitivë me disk shkatërrimi, shufra të mbërthyer, dispozitivë sigurie të komanduar (DSK); dhe dispozitivë kufizues, që aktivizojnë sisteme rregullimi ose që mbyllin ose çaktivizojnë pajisjen apo instalimin, përfshirë komutatorë të aktivizuar nga presioni, nga temperatura ose nga niveli i fluidit dhe dispozitivët e "matjes, kontrollit dhe rregullimit për sigurinë" (DMKRS).
7. "Aksesorë nën presion" janë dispozitivët që kanë funksion shërbimi, vëllimi i mbyllur i të cilëve i nënshtrohet presionit.
8. "Pajisje të transportueshme nën presion" janë enët (bombolat, tubat, enë nën presion, bateritë e bombolave), cisternat e çmontueshme, kontejnerët cisternë të lëvizshëm, rezervuarët e vagonëve cisternë, cisternat e automjeteve cisternë, të cilat përdoren për transportin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, si dhe për transportin e substancave e përzierjeve të tjera, sipas klasifikimit të bërë në marrëveshjen ndërkombëtare për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR), përfshirë ventilat e tyre dhe aksesorë të tjerë, të përdorur për transportimin e këtyre të fundit.
9. "Instalim nën presion" është një sistem i përbërë nga tërësia e pajisjeve nën presion, të montuara së bashku, i cili shërben për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve nën presion.
10. "Fluide" janë gazet, lëngjet dhe avujt në gjendje të pastër, si dhe përzierjet. Një fluid mund të përmbajë një suspension trupash të ngurtë.
11. "Përdorim i pajisjeve/instalimeve nën presion" është vënia në shfrytëzim ose heqja nga puna, transporti, riparimi, përshtatja, si dhe mirëmbajtja e pajisjeve/instalimeve nën presion.
12. "Montimi" është bashkimi i pajisjeve nën presion dhe aksesorëve të tyre, sipas metodikës përkatëse, për të realizuar funksionin, për të cilin janë projektuar.
13. "Vënia në shfrytëzim" është fillimi i veprimtarisë, për të cilën është projektuar dhe montuar pajisja/instalimi nën presion.
14. "Heqja nga puna" është ndalimi i menjëhershëm i shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion.
15. "Prodhues" është personi juridik, i cili prodhon një pajisje nën presion dhe e vendos në treg këtë pajisje nën emrin apo markën e tij tregtare.

16. "Operator ekonomik" është prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi, shpërndarësi dhe personi fizik apo juridik që monton dhe përdor pajisje apo instalime nën presion në funksion të një veprimtarie tregtare.
17. "Montues ose instalues" është personi apo operatori i licencuar, sipas legjislacionit në fuqi, për të kryer montime të pajisjeve dhe instalimeve nën presion.
18. "Ndalim i përdorimit të pajisjeve/instalimeve nën presion" është masa, e cila ndalon përdorimin e pajisjes/instalimit nën presion që nuk plotëson kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
19. "Mbikëqyrja e tregut të pajisjeve nën presion" janë veprimtaritë e kryera dhe masat e marra nga inspektorati shtetëror përgjegjës për të garantuar përputhshmërinë e pajisjeve/instalimeve nën presion me kërkesat ligjore në lidhje me të, me qëllim që të mos rrezikohen shëndeti, siguria ose aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik.
20. "Mbikëqyrja prej organit të miratuar/notifikuar" është procesi i vlerësimit të konformitetit, i kryer nga një organ i miratuar/notifikuar, në fazën e projektimit dhe prodhimit të një pajisjeje/instalimi nën presion, sipas përcaktimit të rregullit teknik përkatës.
21. "Organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit" është organi i referuar në legjislacionin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, dhe i miratuar nga ministri përgjegjës, për kryerjen e vlerësimit të konformitetit të pajisjeve/instalimeve nën presion, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
22. "Certifikatë konformiteti" është dokumenti i lëshuar nga organi i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit, në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përshkruara në rregullat teknike përkatëse, i cili pasqyron rezultatet e inspektimit teknik të pajisjes/instalimit nën presion, lidhur me plotësimin e kërkesave thelbësore të sigurisë.
23. "Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion" është organi shtetëror, në varësi të ministrisë përgjegjëse për industrinë, që kryen veprimtarinë e parashikuar në këtë ligj dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm.
24. "Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë" është marrëveshja e nënshkruar ndërmjet operatorit ekonomik, për pajisjen/instalimin nën presion, me një shoqëri sigurimi, që siguron mbulimin e dëmeve ndaj jetës, shëndetit, pronës së qytetarëve, që mund të shkaktohen nga pajisjet/instalimet nën presion, të operatorëve ekonomikë që i kanë në pronësi apo i administrojnë ato.
25. "Libër i pajisjeve/instalimeve nën presion" është dokumenti, në të cilin pasqyrohen të dhënat në lidhje me parametrat teknikë, kohën e prodhimit, subjektin që e ka në pronësi/përdorim, rezultatet e inspektimeve teknike të pajisjes/instalimit nën presion. Ky dokument administrohet nga operatori ekonomik dhe vihet në dispozicion të inspektoratit shtetëror përgjegjës dhe organeve të miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit, sipas kërkesave ligjore në fuqi.
26. "Deklaratë konformiteti CE" është dokumenti i hartuar nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit apo, sipas rastit, të instaluesit të pajisjes/instalimit nën presion, i cili përshkruan të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj pajisjes/instalimit,

përfshirë edhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse të përputhshmërisë me rregullat teknike dhe rregulloret përkatëse.

27. "Vërtetim përputhshmërie" është dokumenti i hartuar dhe i lëshuar nga organi i miratuar/notifikuar që kryen vlerësimin e konformitetit të projektit të hartuar prej projektuesit, i cili përshkruan rezultatet e përputhshmërisë me rregullat teknike të projektit të hartuar për pajisjet/instalimet nën presion, nga personat apo subjektet e licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

28. "Ministria" është ministria përgjegjëse për industrinë.

29. "Ministri" është ministri përgjegjës për industrinë.

KREU II

PROJEKTIMI I PAJISJEVE/INSTALIMEVE NËN PRESION

Neni 4

Projektimi dhe shqyrtimi i projektit teknik të pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Të gjitha pajisjet/instalimet nën presion prodhohen, montohen dhe vihen në shfrytëzim në përputhje me projektin teknik përkatës, të hartuar nga subjekte projektuese të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi, dhe procedurën përkatëse të montimit.
2. Subjekti projektues harton projektin teknik, në përputhje me rregullat teknike, dhe mban përgjegjësi për projektin e hartuar.
3. Përpara fillimit të procedurës së montimit të pajisjes/instalimit nën presion, operatorët ekonomikë marrin masa për vlerësimin e konformitetit të tij, nga një organ i miratuar/notifikuar për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me rregullat teknike përkatëse.
4. Organi i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit shqyrton përputhshmërinë e projektit të paraqitur me rregullat teknike përkatëse dhe, nëse e gjen në përputhje me to, lëshon vërtetimin e përputhshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.
5. Inspektorati shtetëror përgjegjës mbikëqyr zbatimin e këtij detyrimi nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

KREU III

MONTIMI I PAJISJEVE/INSTALIMEVE NËN PRESION

Neni 5

Montimi i pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Montimi i pajisjeve/instalimeve nën presion kryhet vetëm nga subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Instaluesi kryen montimin e pajisjeve/instalimeve nën presion, në përputhje me rregullat e rregulloret teknike përkatëse, dhe është përgjegjës për garantimin e kërkesave thelbësore të sigurisë së montimit të pajisjes/instalimit nën presion.

3. Pasi montohet dhe përpara vënies në shfrytëzim, pajisja/instalimi nën presion i nënshtrohet inspektimit teknik prej organeve të miratuara/notifikuara.

Neni 6

Deklarata e konformitetit "CE"

1. Çdo pajisje/instalim nën presion, përpara hedhjes në treg dhe vënies në shfrytëzim, duhet të shoqërohet me deklaratën e konformitetit "CE", të lëshuar nga prodhuesi, ku përfshihet edhe procedura e vlerësimit të konformitetit për fazën e shfrytëzimit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse.
2. Montimi i pajisjeve/instalimeve nën presion bëhet nga subjekte instaluese, të pajisura me licencat përkatëse, të cilat janë detyruara të lëshojnë deklaratën e konformitetit "CE" për instalimin nën presion, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse.

Neni 7

Regjistrimi i pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Para vënies në shfrytëzim, operatori ekonomik, që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, është i detyruar ta regjistrojë atë në librin e pajisjeve/instalimeve nën presion, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.
2. Regjistrimi bëhet pasi operatori ekonomik ka depozituar, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet dhe instalimet nën presion, të dhënat e pajisjes/instalimit, deklaratën e konformitetit "CE" dhe specifikimet teknike të pajisjes/instalimit nën presion. Regjistrimi përmban:
 - a) numrin unik të identifikimit;
 - b) emrin dhe adresën e prodhuesit. Për rastin e instalimeve, të instaluesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;
 - c) objektin e deklaramentit (identifikimin e produktit, përfshirë edhe një fotografi), në përputhje me legjislacionin përkatës, në lidhje me të;
 - ç) referencën, ndaj standardeve të harmonizuara përkatëse që janë zbatuar, ose ndaj specifikimeve teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar përputhshmëria.
3. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion i ruan këto të dhëna në database-in e vet.

KREU IV

SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE/INSTALIMEVE NËN PRESION

Neni 8

Përgjegjësitë e operatorit ekonomik dhe punëmarrësit për shfrytëzimin e pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Operatori ekonomik përgjegjës, që vë në shfrytëzim pajisjen/instalimin nën presion, duhet: a) të marrë masa që të sigurojë jetën dhe shëndetin e punëmarrësve, gjatë shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, në përputhje me legjislacionin përkatës për sigurinë në punë të punëmarrësve;

- b) të vendosë në përdorim pajisje/instalime nën presion që plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
- c) të marrë masat e duhura që pajisjet/instalimet nën presion, gjatë përdorimit, të mirëmbahen në një nivel të tillë që të plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Operatori ekonomik përgjegjës harton, duke vlerësuar shkallën e rrezikut, një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut, që përmban masa me karakter teknik e organizativ, të cilat duhet të zbatohen prej punëmarrësve dhe operuesve të pajisjeve/instalimeve nën presion, në përputhje me rregullin teknik përkatës dhe kushtet specifike të vendeve të punës së veprimtarisë.
3. Operatori ekonomik përgjegjës merr masa që punëmarrësit të disponojnë të dhënat dhe udhëzimet e duhura të përdorimit të pajisjeve/ instalimeve nën presion që ata përdorin gjatë procesit të punës.
4. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve/instalimeve nën presion përmbajnë, të paktën, treguesit për sigurinë dhe shëndetin, për sa u përket:
- a) kushteve të shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion;
- b) situatave anormale të parashikueshme;
- c) dhënies së ndihmës së parë mjekësore, në rast aksidenti.
5. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve/instalimeve nën presion duhet të jenë të kuptueshme për punëmarrësin.
6. Operatori ekonomik ka përgjegjësi që, në çdo rast, përdorimi i pajisjeve/instalimeve nën presion të bëhet nga punëmarrës që ka përgatitje të dokumentuar me dëshmi aftësie, e cila lëshohet nga një organ i miratuar nga ministri, i akredituar për certifikimin e personelit që kryen punë me pajisje/ instalime nën presion.

Neni 9

Vënia në shfrytëzim

1. Pas instalimit dhe para vënies në shfrytëzim, pajisjet/instalimet nën presion të instaluara duhet të pajisen me deklaratë konformiteti "CE", të lëshuar nga montuesi/instaluesi, sipas parashikimeve të nenit 6, pika 2, të këtij ligji.
2. Çdo pajisje/instalim nën presion, të cilës i ndryshohet destinacioni fillestar apo tek e cila ndërhyhet, për efekt të mirëmbajtjes ose ndryshimit të skemës së funksionimit, duhet të ripajiset me certifikatë konformiteti, të lëshuar nga një organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit, për të vërtetuar plotësimin e kërkesave thelbësore të sigurisë së pajisjes/instalimit nën presion pas ndërhyrjes së kryer, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në rast se pajisja/instalimi nën presion nuk është në përputhje me kushtet thelbësore të sigurisë dhe përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, vlerat materiale dhe ndotjen e mjedisit, inspektorati shtetëror përgjegjës urdhëron heqjen nga puna dhe ndalimin e menjëhershëm të përdorimit, derisa të sigurohet rikthimi i pajisjes/instalimit nën presion në kushtet e sigurisë, të vërtetuar me certifikatën përkatëse të konformitetit.

4. Përpara vënies dhe gjatë shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, operatorët ekonomikë, që kanë pronësinë apo i administrojnë ato, duhet të jenë të pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile, e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, për të garantuar mbulimin e dëmeve që mund të shkaktohen ndaj mjedisit, jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarëve.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kategoritë e operatorëve ekonomikë që i nënshtrohen detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, si dhe kufirin minimal të përgjegjësisë së tyre, që mbulohet nga kontrata e sigurimit.

Neni 10

Mirëmbajtja e pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Operatori ekonomik, që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, siguron mirëmbajtjen e saj, në përputhje me rregullat teknike.

2. Mirëmbajtja e pajisjes/instalimit nën presion realizohet nëpërmjet shërbimeve teknike, të planifikuara dhe të paplanifikuara, sipas nevojës. Mirëmbajtja duhet të kryhet në përputhje me rregullat përkatëse teknike të saj. Pas kryerjes së mirëmbajtjes, operatori ekonomik, që ka në pronësi apo administrim pajisjen/instalimin nën presion, kërkon inspektimin e saj, nga organet e miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit, për të kryer vlerësimin e përputhshmërisë me kriteret thelbësore të sigurisë.

Neni 11

Këqyrja e avarisë

1. Për çdo rast avarie në pajisjet/instalimet nën presion, me pasoja ndaj jetës, shëndetit, pronës së qytetarëve dhe mjedisit, operatori ose përfaqësuesi i tij njofton, sa më parë, inspektoratin shtetëror përgjegjës për pajisjet dhe instalimet nën presion, për këqyrjen e tij.

2. Ndalohet riparimi apo ndërhyrja në pajisjet/instalimet nën presion deri në përfundimin e këqyrjes nga ana e inspektoratit, përveç rastit kur inspektorati shtetëror përgjegjës jep një miratim paraprak.

3. Operatori ose përfaqësuesi i autorizuar i tij është i detyruar të vërë në dispozicion të inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet /instalimet nën presion çdo të dhënë që i kërkohet për këtë rast.

4. Kur avaria e shkaktuar në pajisjet/instalimet nën presion shoqërohet me aksident, rrezikim të jetës së njerëzve e kafshëve apo dëmtim të rëndë të pronës, inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion bashkëpunon me organet e tjera përkatëse shtetërore për këqyrjen e avarisë.

5. Pas përfundimit të këqyrjes së avarisë, inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet /instalimet nën presion harton raportin, në të cilin përcakton avarinë, shkaqet, përgjegjësitë dhe rekomandimet dhe, sipas rastit, ia përcjell atë organeve kompetente.

KREU V
MBIKËQYRJA E PAJISJEVE/INSTALIMEVE NËN PRESION

Neni 12

Organet që kryejnë mbikëqyrjen dhe vlerësimet e konformitetit periodik e të veçanta Pajisjet/instalimet nën presion, me qëllim verifikimin e plotësisë së kërkesave të këtij ligji, u nënshtrohen inspektimit dhe kontroleve nga:

- a) inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi;
- b) organet e miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit, që kryejnë inspektime e kontrole periodike dhe të veçanta të vlerësimit të konformitetit, në përputhje me ligjin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore dhe rregullin teknik përkatës, sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 13

Inspektimet dhe vlerësimet e konformitetit periodik e të veçantë

1. Operatori ekonomik, që ka në pronësi apo administrim pajisjen/instalimin nën presion, është përgjegjës për kryerjen e inspektimeve apo kontroleve periodike e të veçanta të pajisjeve/instalimeve nën presion, për vlerësimin e konformitetit dhe përputhshmërisë me kërkesat thelbësore të sigurisë, sipas rregullit teknik përkatës. Pajisja/instalimi nën presion i nënshtrohet vlerësimit të konformitetit në mënyrë periodike dhe, në raste të veçanta, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe rregullit teknik përkatës.
2. Rezultatet e kontrollit pasqyrohen në certifikatën e konformitetit që organi i miratuar i lëshon operatorit ekonomik. Të dhënat dhe rezultatet e kontrollit regjistrohen dhe ruhen në bazën e të dhënave të operatorit ekonomik, për një periudhë jo më pak se 10 vjet, dhe u vihen në dispozicion, sipas kërkesës, inspektoratit shtetëror përgjegjës, organeve përkatëse shtetërore, apo organeve të miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit. Organet e miratuara/notifikuara janë të detyruara të ruajnë të dhënat e inspektimeve, në bazën e tyre të të dhënave, dhe të dërgojnë, periodikisht, çdo katër muaj, informacion për to pranë ministrisë përgjegjëse dhe inspektoratit përgjegjës.
3. Ndalohet shfrytëzimi i pajisjeve/instalimeve nën presion në rast se ka përfunduar afati i vlefshmërisë së përcaktuar në certifikatën e konformitetit.
4. Ndalohet shfrytëzimi i pajisjeve/instalimeve nën presion nëse, nga kontrolli teknik periodik ose i veçantë, rezulton se ato nuk plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik përkatës.
5. Organi i miratuar i vlerësimit të konformitetit, që kryen kontrollin teknik periodik ose të veçantë, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion në rast se, nga kontrolli teknik, rezulton se pajisja/instalimi nën presion nuk plotëson kushtet thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik përkatës. Inspektorati shtetëror përgjegjës, në këtë rast, vendos për operatorin detyra përkatëse, të cilat duhet të zbatohen për rikthimin e

pajisjes/instalimit nën presion në gjendjen e sigurisë, ose urdhëron heqjen nga puna dhe ndalimin e menjëhershëm të përdorimit, deri në rikthim në kushte të konformitetit.

Neni 14

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion

Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë në fushën e projektimit, prodhimit, montimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, është inspektorati shtetëror në varësinë e ministrisë përgjegjëse për industrinë.

Neni 15

Organet e miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit

1. Organet e miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit kryejnë kontrollin teknik periodik për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji dhe ligjit për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.
2. Operatorët ekonomikë, përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion, marrin të gjitha masat për të kryer vlerësimin e konformitetit, gjatë fazës së projektimit e prodhimit, si dhe inspektimin teknik periodik e të veçantë të pajisjes/instalimit apo edhe aksesoreve të sigurisë nën presion, sipas përcaktimeve të rregullave teknike përkatëse.

Neni 16

Detyrat e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion kryen këto detyra:

1. Ndjek zbatimin e detyrimit të operatorëve ekonomikë që pajisjet/instalimet nën presion t'i nënshtrohen vlerësimit të konformitetit nga një organ i miratuar/notifikuar.
2. Kryen inspektime tek operatorët ekonomikë privatë ose entet publike që ushtrojnë veprimtari me pajisje/instalime nën presion, ku vlerëson nëse:
 - a) ushtrimi i aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
 - b) miratimi për zhvillimin e aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion është marrë në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 - c) është përgatitur dokumentacioni teknik i nevojshëm për vendosjen e pajisjeve dhe instalimeve nën presion;
 - ç) instalimi dhe testimi i pajisjeve/instalimeve nën presion është bërë në përputhje me legjislacionin dhe aktet teknike në fuqi;
 - d) pajisja/instalimi nën presion është mirë- mbajtur rregullisht gjatë funksionimit të saj dhe nëse ajo është e kontrolluar dhe testuar, në përputhje me rregullat teknike në fuqi;
 - dh) personat që përdorin pajisjet/instalimet nën presion dhe personat që punojnë në mirëmbajtjen e tyre plotësojnë kushtet e përcaktuara për këto veprimtari.

3. Mban evidenca të historikut të inspektimeve teknike, avarive të ndodhura, regjistrit të pajisjeve/instalimeve nën presion, të përdorura nga subjektet përkatëse.

Neni 17

Të drejtat e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion

1. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion ka të drejtën t'i krijojehet akses në mjediset ku ndodhen pajisje/instalime nën presion në shfrytëzim, për kryerjen e inspektimit përkatës, në përputhje me programin e planifikuar, si dhe në rastet e paparashikuara, kur është shkaktuar një aksident, si rezultat i një avarie në pajisje/instalime nën presion.

2. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion mund të shtyjë afatin e inspektimit të planifikuar kur pajisja/instalimi nën presion është jashtë funksionit, për shkak të riparimeve apo mirëmbajtjes.

3. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion kërkon ndërhyrjen e forcave të rendit kur:

a) inspektori cenohet për shkak të kryerjes së detyrës;

b) nuk zbatohet, në mënyrë të përsëritur, urdhri i ndalimit të shfrytëzimit të një pajisjeje/instalimi nën presion, që përbën rrezik për mjedisin, jetën, shëndetin e pasurinë e njerëzve;

c) nuk lejohet, në mënyrë të paarsyeshme, të hyjë në mjediset ku ndodhen pajisjet/instalimet nën presion për kryerjen e inspektimit të tyre në punë.

4. Për realizimin e këtyre detyrave, inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion bashkëpunon edhe me organet e tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore.

5. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion urdhëron heqjen nga përdorimi të pajisjeve/instalimeve nën presion, në rastet kur ato nuk plotësojnë kërkesat thelbësore ligjore të sigurisë.

6. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion, kur ka të dhëna se në ndonjë qendër prodhimi apo shfrytëzimi mbahen ose gjenden pajisje/instalime nën presion, të cilat nuk përmbushin kërkesat thelbësore të sigurisë, ka të drejtë:

a) të hyjë në këto qendra dhe të kryejë atje çdo inspektim që mund të jetë i nevojshëm;

b) të heqë nga puna dhe të vendosë ndalimin e menjëhershëm të shfrytëzimit të çdo pajisjeje/ instalimi nën presion, e cila rezulton e pasigurt.

7. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion ka të drejtë të kërkojë nga organet e miratuara/notifikuara çdo informacion që ka të bëjë me fushën e inspektimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, të cilin e përdor për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të vet, duke ruajtur konfidencialitetin, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18

Kufizimet gjatë ushtrimit të detyrës dhe ndalimet në mbarim të funksionit

Përveç sa parashikohet në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, inspektori i

inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion i nënshtrohet edhe kufizimeve të parashikuara në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, nga inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion si më poshtë:

- a) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 4, me 500 000 lekë;
- b) për shkelje të kërkesave të pikës 3, të nenit 4, me 50 000 lekë;
- c) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 5, me 200 000 lekë;
- ç) për shkelje të kërkesave të pikave 2 e 3, të nenit 5, me nga 200 000 lekë për secilin rast;
- d) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 6, me 500 000 lekë;
- dh) për shkelje të kërkesave të pikës 2, të nenit 6, me 500 000 lekë;
- e) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 7, me nga 50 000 lekë për secilin rast;
- ë) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 8, me 500 000 lekë;
- f) për shkelje të kërkesave të pikës 6, të nenit 8, me 50 000 lekë;
- g) për shkelje të kërkesave të pikës 3, të nenit 9, me 500 000 lekë;
- gj) për shkelje të kërkesave të pikës 4, të nenit 9, me 500 000 lekë;
- h) për shkelje të kërkesave të pikës 2, të nenit 10, me nga 500 000 lekë;
- i) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 11, me 500 000 lekë;
- j) për shkelje të kërkesave të pikës 2, të nenit 11, me 500 000 lekë;
- k) për shkelje të kërkesave të pikave 1, 3 e 4, të nenit 13, me nga 500 000 lekë për secilin rast.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

3. Të ardhurat nga masat administrative të aplikuara, sipas pikës 1 të këtij neni, derdhen, tërësisht, në Buxhetin e Shtetit.

Neni 20

Përsëritja e shkeljeve

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion, në rast përsëritjeje të shkeljeve nga subjekti i inspektimit vendos ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë deri në riparimin e shkeljes.

Neni 21

Publikimi

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion publikon, në median e shkruar dhe atë elektronike, masat e marra ndaj operatorëve ekonomikë, me qëllim informimin e publikut.

Neni 22

Miratimi i rregullave teknike dhe akteve të tjera nënligjore në fushën e pajisjeve/instalimeve nën presion

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit përgjegjës për tregtinë, të miratojë rregullat teknike në fushën e pajisjeve/instalimeve nën presion, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në përputhje edhe me ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar.

Neni 23

Dispozita kalimtare

Deri në miratimin e organeve të akredituara, që do të kryejnë certifikimin e personelit që kryen punë me pajisje/instalime nën presion, dhe jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ky funksion do të kryhet nga një komision i miratuar nga ministri përgjegjës, anëtarët e të cilit duhet të jenë inxhinierë të fushës së industrisë dhe me eksperiencë shumëvjeçare në këtë fushë.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9504, datë 6.4.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani